



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 03 tetor 2019
Nr. Ref.:RK 1436/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI46/19

Parashtrues

Naser Husaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev.
nr. 363/18, të 13 nëntorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Naser Husaj, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 363/18, të 13 nëntorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenet: 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 18 mars 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 mars 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Bajram Ljatifi (anëtarë).
7. Më 8 prill 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës KI46/19 dhe një kopje të saj ia dërgoi Gjykatës Supreme, në pajtim me ligjin.
8. Më 4 shtator 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi parashtron për herë të tretë kërkesë në Gjykatë, kërkesa e parë KI22/16, kërkesa e dytë KI128/17 dhe kërkesa e tanishme KI46/19, të cilat për nga objekti i çështjes janë të ndryshme, prandaj Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të përsërisë faktet e kërkesave të mëparshme KI22/16 dhe KI 128/17.
10. Më 22 dhjetor 2014, parashtruesi ushtroi kërkesëpadi për vërtetimin e pronësisë së parcelave me nr. 85/1, 80/1, 80/2, 87/1 dhe 89, në sipërfaqe të përgjithshme prej 4,43.72 hektarë, të regjistruara në listën poseduese nr. 313 ZK Vitomiricë, sipas kontratës së shitblerjes.

11. Më 29 maj 2014, Gjykata Themelore në Pejë, me Aktgjykimin C. nr. 1127/2017, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit me të cilën kishte kërkuar vërtetimin e pronësisë së parcelave të lartcekura, sipas kontratës së shitblerjes, me arsyetimin se parashtruesi nuk ka ofruar prova origjinale për blerjen e parcelave dhe se të njëjtat janë blerë nga dëshmitarët, gjersa parashtruesi ka qenë i autorizuar i të paditurit V. P. për t'ia shitur tokën të paditurit.
12. Më 3 korrik 2014, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve të pretenduara të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
13. Më 17 korrik 2018, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin Ac. nr. 3441/2017, refuzoi, si të pabazuar, ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, C. nr. 1127/2017, të 29 majit 2014, me arsyetimin vijues: *“Pretendimet ankimore të paditësit kjo gjykatë i vlerëson, si të pabazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore e as aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, pasi që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ashtu siç u cek më lart në arsyetim të këtij aktgjykimi”*.
14. Më 10 shtator 2018, parashtruesi ushtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen dhe lënda të kthehet për gjykim në merita.
15. Më 13 nëntor 2018, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Rev. nr. 363/2018, hedh poshtë si të palejuar kërkesën për revizion të ushtruar nga parashtruesi, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3441/2017, të 17 korrikut 2018, për shkak se mjeti juridik i ushtruar nga parashtruesi nuk ishte i lejuar në bazë të nenit 211.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31, 46 dhe 54 të Kushtetutës, për shkak se parcelat e lartcekura, pretendon se i ka blerë në bazë të kontratës mbi shitblerjen.
17. Parashtruesi nga Gjykata, kërkon prishjen e të gjitha vendimeve të gjykatave të rregullta dhe kthimin e lëndës në rigjykim dhe vendosjen e së njëjtës në merita.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
19. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

20. Gjykata, më tej, i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]”.

21. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin Rev. nr. 363/18, të 13 nëntorit 2018 të Gjykatës Supreme; ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe, e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
22. Megjithatë, përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

23. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, me aktvendimin e kontestuar ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31, 46 dhe 54 të Kushtetutës, sepse nuk është marrë parasysh kontrata e shitblerjes së parcelave kontestuese.
24. Gjykata, vëren se parashtruesi i kërkesës në mënyrë shprehimore i përmend shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, duke i ndërlidhë shkeljet e pretenduara me vërtetimin e fakteve, përkatësisht mos marrjen parasysh të kontratës së shitblerjes mbi parcelat kontestuese, duke mos elaboruar më tej në baza kushtetuese, se si dhe pse erdhi deri të shkelja e këtyre neneve konkrete të Kushtetutës.
25. Lidhur me pretendimet e lartcekura, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi vërtetimin e fakteve. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (Shih, rasti KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
26. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ-së dhe po ashtu edhe me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe se nuk mund të bëhen vlerësime abstrakte se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
27. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse në një proces provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
28. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore nuk ishin të padrejta apo arbitrare. (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
29. Në rrethanat e rastit konkret në mënyrë që edhe më konkretisht të elaborohen parimet e përgjithshme të gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se Gjykata

Supreme e kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit si “të palejuar” - në aspekt procedural dhe pa shqyrtuar meritat e kërkesës. Gjykata Supreme, duke interpretuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore ashtu siç ka vlerësuar se është mënyra më e drejtë për interpretimin e tyre, kishte theksuar se kërkesa për revizion duhet të shpallet e palejueshme meqë vlera e kontestit është nën 3,000 €. Pra, Gjykata Supreme, në baza procedurale të pranueshmërisë e ka refuzuar kërkesën e parashtruesit.

30. Më saktësisht, Gjykata Supreme në Aktvendimin e saj kishte theksuar si në vijim: *“Sipas dispozitës së nenit 211.2 të LPK-së, revizioni nuk është i lejuar në kontestet pasurore-juridike, në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit ose me kryerjen e ndonjë veprimi, nëse vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur nuk kalon shumën 3.000 €. Vlera e objektit të kontestit në këtë çështje juridike është 1.000,00 €, e cila nuk kalon limitin e caktuar me ligj”*.
31. Në këtë aspekt, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme apo në gjykatat e tjera të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë. (Shih, rasti KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjokaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
32. Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate tregon se ka pasur edhe raste të tjera kur është kontestuar një Aktvendim i Gjykatës Supreme – sikurse ky i tanishmi - përmes së cilit ishin refuzuar si të palejuara kërkesat për revizion në të cilat vlera e kontestit ishte nën 3,000 €. Në rastet e tilla Gjykata, sikurse në rastin e tanishëm, është fokusuar vetëm në atë se a kanë përfutur parashtruesit nga një gjykim i drejtë dhe i paanshëm duke mos u lëshuar në çështje të ligjshmërisë dhe aspekteve të interpretimit të ligjit procedural dhe material duke qenë se prerogativat e tilla janë kompetencë e gjykatave të rregullta. Andaj, Gjykata rastet e tilla i ka shpallur të papranueshme si qartazi të pabazuara. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI66/18 parashtrues *Sahit Muçolli*, Aktvendim i 6 dhjetorit 2018, KI110/16 parashtrues *Nebojša Đokić*, Aktvendim i 24 marsit 2017, KI24/16 parashtrues *Avdi Haziri*, Aktvendim i 4 nëntorit 2016, KI112/14 parashtrues *Srboljub Krstić*, Aktvendim i 19 janarit 2015, KI84/13 parashtrues *Gani, Ahmet dhe Nazmije Sopaj*, Aktvendim i 18 nëntorit 2013).
33. Në linjë me praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, Gjykata më tej thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta, përkatësisht me vendimet e Gjykatës Supreme, të Apelit dhe atë Themelore, nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21,; dhe

shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtuese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

34. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe që me Aktvendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ.
35. Si përfundim, në pajtim rregullin 39 (2) të Rregullores së punës kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi